



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Gouvernement

Zyra e Kryeministrit - Kancelarija Premijera- The Prime Minister Office

Në bazë të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publik, neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, neni 40, Zyra e Kryeministrit shpallë:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës :	Zyrtar i/e lartë për koordinim/sigurim të granteve
Klasa e pozitës :	Profesional 1
Koeficienti/ paga :	G4-5.85
Nr. i kërkuar :	1
Data e njoftimit :	16/05/2023
Afati për aplikim :	31/05/2023 - 07/06/2023
Institucioni :	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
Departamenti :	
Divizionii :	Zyra për çështje të Komuniteteve
Vendi Punës :	Prishtinë
Nr. i Referencës:	RN00011625
Kodi:	RPC0005242



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime për realizimin objektivave;
2. Hartimi i prioriteteve të ZÇK për financimin vjetor,
3. Zhvillimi dhe zbatimi i një pakoje financimi për ZÇK, duke përfshirë hartimin dhe shpërndarjen e thirrjes për propozime, hartimin dhe shpërndarjen e formularit për aplikim, formimin e një paneli shqyrtues dhe lehtësimin e aktiviteteve të tij dhe informimi i të gjithë aplikantëve për rezultatet e shqyrtimit,
4. Hartimi i marrëveshjes së granteve, zhvillimi i formave për raportim dhe mbikëqyrje rreth dorëzimit të raporteve nga agjencitë dhe organizatat e zbatimit dhe bën rishikimin e këtyre raporteve,
5. Përcjellja e të gjitha procedurave administrative për transferimin e fondeve për projektet e përzgjedhura / partnerët dhe mbikëqyrja rreth zbatimit dhe ekzekutimit të transferit;
6. Të zhvillojë dhe menaxhojë një sistem monitorimi të granteve në mënyrë që të sigurojë informata të mjaftueshme për projektet e mbështetura dhe efektin e tyre;
7. Të zhvillojë dhe mirëmbajë një bazë të dhënash mbi projektet për komunitetet, duke përfshirë institucionet, prioritetet e donatorëve, llojin e projekteve, zbatimin e partneritetit;
8. Mbështetja, organizimi i takimeve, koordinimi, bashkëpunim i ngushtë me përfaqësuesit e komuniteteve, mbajtja e një korrespondence të efektshme ;
9. Bashkërendon dhe ndërlihd punët sipas nevojës me zyrtaret e tjerë të zyrës për çështje të Komuniteteve dhe zyrave tjera në Zyrën e Kryeministrit;
10. Përgatitë raporte të ndryshme periodike ;
11. Kryen detyra të tjera që ndërlihdhen me pozitën dhe mandatin e zyrës sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende ;
- Të jetë vlerësuar të paktën mirë për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit,
- Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- *Arsimimi i kërkuar:* Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, drejtimi në ekonomi, drejtësi , administratë publike.
- *Kualifikime të posaçme formale:*
- *Përvoja e punës e kërkuar:* Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale.



4. Kërkesat (Njohuri , Aftësi dhe cilësi) e përgjithshme e nevojshme

- Aftësi në menaxhimin e granteve përfshirë edhe njohuri për përzgjedhjen, kontraktimin, buxhetimin dhe monitorimin e projekteve;
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështje teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
- Cilësi gjatë kryerjes së detyrave në fushën profesionale;
- Aftësi për tu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi për të bërë vlerësime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit;
- Njohuri në programet e Microsoft Office;
- Njohja e gjuhës shqipe dhe /ose serbe. Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;
- Të jetë energjik dhe në gjendje të punojë me orar fleksibil dhe trysni kohe, të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë pune.

5. Dokumentet e nevojshme dhe mënyra e dorëzimit

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopjet e vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmonë se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende (e vlefshme nga afati për aplikim).

6. Data e daljes së rezultateve dhe vlerësimi paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë të shpallet me së largu deri më datën 14/06/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data , vendi dhe ora ku zhvillohet intervista me gojë

- 23/06/2023, Ndërtesa e Qeverisë, Zyra e Kryeministrit, Prishtinë

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Njohuri për mandatin e zyrës për çështje të komuniteteve.
- Njohuri për rregulloren (MF) Nr.04/2017 për Kriteret , standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve .
- Njohuri në procesin e monitorimit dhe raportimit .
- Aftësi në menaxhimin e granteve përfshirë edhe njohuri për përzgjedhjen, kontraktimin, buxhetimin dhe monitorimin e projekteve.

9.Mënyra e vlerësimit të kandidatëve /aplikantëve

- Intervistë



10.Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatet

- Përmes e-mailit dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11.Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidateve , fituesi do të shpallet përmes portalit per rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>) Të gjithë kandidatet pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Nuk ka

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

